



INTERREG III A ITALI-SHQIPERI
2000-2006

“BiblioDoc-Inn”



Albanologjia,
Bibliotekonomia
& Management

n. 1 – Janar/Qershor 2006

Bibliotekonomia & Management



Redaktor: **Antonio Lovecchio**

Partner Kooperativa e Shërbimeve Kulturore Ninive

Përkthyes: **Dhurata Vreshtazi**

-- 0 --

Albanologjia & Bibliotekonomia



Përgatiti: **Shazie Guri**

Biblioteka e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Përktheu: **Blertha Guri**



INTERREG III ITALI-SHQIPERI¹

“Promovimi dhe zhvillimi i modeleve inovative të bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave dhe qendrave të dokumentimit italo-shqiptare” (BiblioDoc-Inn) Aksi IV – Mizura 4.1 – Aksioni 4 – Nën Aksioni 4.1

Financuar nga Bashkimi Europian, projekti shënon arritje në drejtim të bashkëpunimit institucional të bibliotekave shqiptare me ato italiane. Ai promovon forma të bashkëpunimit ndërrajonal, krijon mundësira të njohjes së kulturave të dy popujve, të integritit të bibliotekave shqiptare në rrjedhën e atyre europiane. Në këtë projekt janë përfshirë Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, biblioteka publike “Qemal Baholli” e qytetit të Elbasanit, biblioteka publike “Marin Barleti” e qytetit të Shkodrës, Biblioteka e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit të Shtetit Shqiptar.

Projekti synon arritjen e objektivave të tillë si:

- Zbatimin e të drejtës për akses në informacion, të garantuara nga Bashkimi Europian, në dobi të qytetarëve në përgjithësi;
- Lehtësimin e procesit të integritit europian përmes një informacioni të saktë mbi probleme të bashkësisë me interes të veçantë për bashkëpunimin ndërkufitar;
- Zvogëlimin e “dallimeve digjitale” përmes zbatimit të shpërndarjes së teknologjisë infotelematike në administrimin publik në dobi të zonave më të prapambetura;
- Promovimin e trashëgimisë biblio-dokumentare në përgjithësi, veçanërisht asaj të përcaktuar si vlerë kulturore;
- Modernizimin në planin e administrimit, përmirësimin cilësor dhe rritjen e shërbimeve publike.

Për arritjen e këtyre objektivave projekti parashikon realizimin e një programi për hartimin e buletineve tematike periodike dygjuhëshe, kryesisht për konsultim në www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn.htm, por edhe për konvertim në letër në përshtatje me shërbimet tradicionale të bibliotekave të përfshira në projekt; si edhe realizimin e një programi për hartimin e botimeve profesionale.

¹ Në konferencën e mbajtur në Bari më 11-12 tetor të vitit 2001 në kuadër të INTERREG II, u vu në dukje gjendja e vështirë e bibliotekave publike në Shqipëri. Rruga më e sigurtë dhe më efektive për rritjen e bashkëpunimit dhe përmirësimin e drejtimit bibliotekar është përfshirja e drejtpërdrejtë e disa bibliotekave publike dhe qendrave shqiptare të dokumentacionit në struktura-pilot përmes të cilave të pasqyrohen risitë dhe të konsolidohen në territorin shqiptar modele që nxitin zhvillim në këtë fushë.

PERMBLEDHJA

Bibliotekonomia & Management

[Site në Internet, fq. 7](#)

[Revista, fq. 9](#)

[Monografi, fq. 12](#)

-- 0 --

Albanologjia & Bibliotekonomia

[Site në Internet, fq. 18](#)

[Revista, fq. 20](#)

[Monografi, fq. 23](#)

Të dhëna rreth përmbajtjes

Buletini është një përmbledhje e abstrakteve të publikimeve italiane – në fushën e bibliotekonomisë – të ndara në tre seksione: *Bibliotekonomia*, *Historia e bibliotekave* dhe *Cilësia e shërbimeve bibliotekare*. Të tre seksionet mund të prezantohen në të njëjtën kohë ose të alternuar.

Në këtë numër:

1. Seksioni *Bibliotekonomia*:

- Biblioteka;
- Biblioteka digjitale;
- Bibliotekat shkollore (Linjat guidë IFLA/UNESCO);
- Revizionimi i Rregullave Italiane të Katalogimit në bazë të Autorit (RICA);
- Prospektivat dhe problemet e katalogimit të burimeve elektronike (ISBD(ER));
- Kërkime bibliografike në rrjet;
- Profesioni i bibliotekarit.

2. Seksioni *Cilësi e shërbimeve bibliotekare*:

- Analiza ekonomike e bibliotekave;
- Sondazhe statistikore rreth përdorimit të burimeve elektronike;
- Shërbimet e informacionit ndaj publikut;
- Sondazhe rreth rolit të Bibliotekave të Këshillave rajonalë;
- Metodologji të reja për management të bibliotekave;
- Metodologji të reja në drejtimin e koleksioneve librare;
- Bashkëpunimi në drejtimin dhe konservimin e koleksioneve librare.

3. Seksioni *Histori e bibliotekave*:

- Historia e bibliotekave italiane.

Për sitet dhe bankat e të dhënave janë zgjedhur Web-et në bazë të tematikave dhe tipologjive, si: ESSPER (katalogu kolektiv i periodikëve ekonomikë), MAI-Azalai (Meta-OPAC i bibliotekave italiane), Aib-Web (Web i Shoqatës Italiane të Bibliotekave) dhe në fund E-LIS (Bankë të dhënash ndërkombëtare e dokumentave të biblioekonomisë dhe Shkencave të informacionit).



SITE NE INTERNET

***ESSPER**

<http://www.biblio.liuc.it:8080/biblio/essper/default.htm>

Ky sit mundëson aksesin në një katalog kolektiv të specializuar, në të cilin marrin pjesë bibliotekat e shumë fakulteteve universitare si dhe bibliotekat e enteve të studimit të disiplinave ekonomike dhe të shkencave sociale.

Në këtë OPAC janë hedhur informacionet bibliografike të revistave që posedojnë bibliotekat pjesëmarrëse dhe për më tepër është e mundur të gjendet një bibliografi e rëndësishme e artikujve të periodikëve kryesorë italianë ekonomikë. Është përgatitur edhe një *Essper e drejta*, për zonën juridike, me akses nga e njëjta faqe.

Aib-Web

<http://www.aib.it>

Bëhet fjalë për Web-in e Shoqatës Italiane të Bibliotekave (Aib). Aib-Web përmban burime të shumta informative bibliotekonomike të disponueshme në Rrjet, të cilat mund të jenë me interes për të gjithë. Home-page përmban seksione të ndryshme:

- "SegnaWeb" përmban një listë të burimeve Internet të seleksionuara nga bibliotekarët italianë në lidhje me fusha të ndryshme të njohurive <http://www.segnaweb.it/>
- "Dfp" është një repertor i burimeve informative, i dokumentave dhe i shërbimeve të ofruara nga institucionet italiane, për të orientuar lexuesit në përcaktimin e informacioneve publike disponibile në rrjet <http://www.aib.it/dfp/>;
- "Peb" është seksioni i repertoreve të periodikëve bio-mjeksorë elektronikë <http://www.aib.it/aib/commiss/cnur/peb/peb.htm3>.

Ndër seksionet biblioekonomike përmendim:

- "Gfir" guida e burimeve të informacionit të bibliotekomisë në rrjet <http://www.aib.it/aib/editoria/gfir.htm>;
- "I cataloghi on-line italiani" një seksion i pasur dedikuar Opac-ve (që përfshin Mai) <http://www.aib.it/aib/lis/opac1.htm>;
- "Bib" bibliografia italiane e bibliotekave, e librit dhe e informacionit <http://www.aib.it/aib/bib/bib.htm>;
- Janë disponibël gjithashtu dhe versionet elektronike të dy periodikëve të Aib, "**Aib notizie**", e "**Bollettino Aib**"
- "Aib-Cur" lista kryesore e diskutimeve të bibliotekarëve italianë <http://www.aib.it/aib/aibcur/aibcur.htm3>.

Dy seksione të tjera japin informacione rreth meetings, kurseve, seminareve, shpalljes së konkurseve si dhe ofertave të tjera punësimi për aspirantët bibliotekarë.

***MAI-Azalai**

<http://www.aib.it/aib/opac/mai2.htm>

Mai (*MetaOpac Azalai italiano*) u krijua në 1999 nga eksperiencia e repertorit të Opac-ve italianë nën kujdesin e Aib dhe të Katalogut bibliografik virtual të Universiteteve lombarde nën kujdesin e Cilea-s. Mai i bashkohet dy katalogëve kolektivë italianë më të mëdhenj (Sbn e Acnp).

Mai i lejon përdoruesit konsultimin kumulativ të OPAC-ve të gati 200 bibliotekave aktualisht në rrjet. Rezultatet e kërkimeve janë të ndryshme për Opac të ndryshëm, sipas shpejtësisë së përgjigjes dhe ruajtjes së aspektit origjinal të skedave. Drejtëpërdrejtë në çdo Opac, përdoruesi mund të realizojë kërkime të sofistikuara. Kërkimi mund të përqëndrohet në bibliotekat e një rajoni të vetëm, e seleksionueshme edhe nëpërmjet faqes web (<http://www.aib.it/aib/opac/mai3.htm>). Mund të përdoret edhe një faqe e tretë “përzgjedhëse” (<http://www.aib.it/aib/opac/mai.htm>) me të cilën para se të realizosh kërkimin e një dokumenti mund të krijosh një set të personalizuar bibliotekash (të specializuara ose të përgjithshme, të cilat ndodhen në rajone të caktuara, provinca ose komuna) dhe të tipologjive të dokumentave (vetëm monografi, vetëm periodikë, monografi e periodikë) ku mund të aktivohet më pas kërkimi i vërtetë.

***E-LIS : e-prints i bibliotekomisë dhe shkencave të informacionit**

<http://eprints.rclis.org/>

E-Lis është shembulli i parë i banka të dhënash që promovon filozofinë e aksesit të hapur (*Open Access*) për dokumentat specifike të biblioekonomisë dhe shkencave të informacionit (Library and Information Science - *LIS*). Kontributet shkencore janë memorizuar në një server dhe janë klasifikuar sipas skemës E-Lis, e quajtur *JITA*. Bëhet fjalë për një skemë klasifikuese sektoriale për LIS, e cila lejon organizimin dhe kërkimin e informacioneve sipas lëndës. Falë një faqeje grafike, dokumentat mund të kërkohen me anë të kritereve klasike të një OPAC (në bazë të autorit, në bazë të titullit, në bazë të shtëpisë botuese etj...), të gjendet testi i plotë dhe të vihen në përdorim të çdo përdoruesi me synim *no-profit*.



***Arsyet dhe principet e revizionit të RICA : për një kod të ri italian të katalogimit /** Alberto Petrucciani
në **Bollettino AIB*, vol. 45 (qershor 2005), nr. 2, fq. 149-186.

Komisioni Rica, i krijuar muajt e kaluar nga Drejtoria e Përgjithshme për tutelimin e librit, organ i Ministrisë për tutelimin e aktiviteteve kulturore, gjatë fazës fillestare të saj ka përcaktuar arsyet dhe principet për revizionimin e kodit italian aktual të katalogimit RICA (*Rregulla Italiane të Katalogimit në bazë të Autorëve*).

Sipas Komisionit, projekti i revizionimit duhet t'i përkasë tekstit të kodit dhe jo principeve katalografike në të cilat bazohet (*Principi i Parisit*), meqë kodi në fuqi duket se nuk është më i përshtatshëm për nevojat aktuale, sepse ndryshojnë format e prodhimit dhe të konsultimit të katalogut dhe shtohen tipologjitë e materialeve bibliografike të bibliotekës, të ndryshme nga ato të shtypit.

Nevojitet një kod katalogimi, i cili duhet të jetë një instrument i qartë i konsultimit të shpejtë dhe i trajnimit profesional për të interesuarit.

Synohet të përballohet revizionimi duke marrë në konsideratë aktivitetet ndërkombëtare aktuale në fushën e katalogimit: referimi kryesor, në nivel teorik, është përbërë nga raporti final i studimit FRBR, e për më tepër nga punimet e fundit IFLA rreth titujve për entet, Unimarc etj...

Vendndodhja në Bibliotekë: BR 6A 8

***Hyrje në Contingent Valuation : një instrument për analizimin ekonomik të bibliotekave /** Roberto Ventura,
në **Biblioteche oggi*, vol. 23 (shtator 2005), nr. 7, fq. 44-62.

Prej disa vitesh, në fushën anglosaksone, *Cultural economics* – një degë e veçantë e ekonomisë së aplikuar në sektorin e të mirave kulturore – ofron instrumenta të analizimit ekonomik për të matur shkallën e produktivitetit të institucioneve kulturore në përdorimin e fondeve publike në dispozicion të tutelimit dhe qarkullimit të kulturës, dhe për të treguar efikasitetin dhe eficientën e metodave organizative të përshtatura. Rendikonti përbën një formë transparente në drejtim të qytetarëve që paguajnë taksat dhe është i nevojshëm për organet qeverisëse për të stabilizuar ndarjen e financimeve për sektorët administrativë që drejojnë të mirat dhe shërbimet kulturore.

Ndër teknikat ekonometrike të vëna në dispozicion të *Cultural economics* është *Contingent Valuation* që lejon sondazhin e identitetit të kërkesës dhe sjelljen e konsumatorëve në sektorin e shërbimeve kulturore, edhe nën këndvështrimin e një drejtimi efikas të ofertës.

Me *Contingent Valuation* është e mundur të përcaktohet si disponibiliteti për shpenzim (*willingness to pay* - **WTP**) nga ana e qytetarit për të patur përmirësimin e një shërbimi, ashtu edhe disponibilitetin kompensim ekonomik (*willingness to accept* - **WTA**) në rastin kur shërbimi nuk është më disponibël.

Sondazhet e *Contingent Valuation* të aplikuara në bibliotekë do të lejonin kuptimin më të thellë të fizionomisë së kërkesës së përdorimit dhe egzistencës së shërbimeve të veçanta; dallimin se cilët prej qytetarëve mund të jenë subjekte të tarifave dhe cilët duhet të sigurohen gratis; verifikimin e egzistencës së kërkesave të mundshme për t'u sadisfaksionuar me forma mikse të kapitaleve në shtesë të financimeve publike (për shembull fund raising ose shitja e shërbimeve të avancuara).

Vendndodhja në Bibliotekë: BR 6A 4

***Biblioteka digjitale : përcaktime, përbërës dhe problematika / Riccardo Ridi**

në: *Bollettino AIB, vol. 45 (shtator 2004), 3, fq. 273-344.

Biblioteka digjitale është një entitet "*jo material*" ku dokumentat digjital të tipologjive të ndryshme, drejtohen dhe katalogohen në mënyrë elektronike, e kështu konservohen dhe bëhen disponibël.

Aspekte të ndryshme (ku aksesimi në informacion, konservimi, standartizimi, modalitetet e kërkimit, metadat, etj.) i japin bibliotekës digjitale një dimension gati real edhe pse është e vendosur në një kontekst më të gjerë dhe më shumë jo material si WWW (*World Wide Web*). Në referim të këtij të fundit, biblioteka digjitale duket se konfigurohet si "*një oaz i vogël ku egziston rregull dhe stabilitet i të dhënave*": Përdoruesi në brendësi të këtij oazi gjen instrumentat bibliografikë të nevojshme për të rikërkuar informacionin cilësor.

Jashtë bibliotekës digjitale, por në brendësi të web-it, ka subjekte të ndryshme (shoqatat e shtëpive botuese, site kërkimi, sisteme repertori, etj.) të cilët po japin kontributin e tyre në realizimin e një web-i më pak kaotik nëpërmjet racionalizimit të ofertës së dokumentacionit digjital dhe përfundimit të rekuperimit të informacioneve. Në këtë klimë të re, biblioteka digjitale duhet të nisi projekte bashkëpunimi me të gjithë subjektet e ndryshme, përndryshe rrezikon të izolohet dhe të autoeliminohet.

Vendndodhja në Bibliotekë: BR 6A 8

***Prospektiva dhe probleme të katalogimit të burimeve elektronike : një debat ndërkombëtar plot zhvillime / Matteo Barucci**

në: *Biblioteche oggi, vol. 23 (nëntor 2005), nr. 9, fq. 7-18.

Prej vitesh kataloguesit gjenden përballë një seri vështirësish si pasojë e një aplikimi të dobët të ISBD në materialet dokumentuese si burime elektronike.

Unanime ideja e revizionimit të rregullave të katalogimit të burimeve elektronike (ISBD-ER) dhe e integritetit të rasteve të ndryshme të materialit jo librar në një strukturë katalografike më të qartë.

Prej vitesh dy organizma ndërkombëtar të rëndësishëm – ISBD Review Group dhe Joint Steering Committee for the revision of AACR2 (JSC) – punojnë paralelisht për revizionimin e rregullave të katalogimit të burimeve elektronike dhe në përgjithësi për realizimin e një kodi katalografik ndërkombëtar i vlefshëm për të gjitha tipologjitë e dokumentave (monografi, seriale, kartografi, materiale jo librare, muzikore...).

JSC ka aprovuar modifikimet e kapitullit 9 të kodit AACR2 (kapitull rreth rregullave të katalogimit të burimeve elektronike), ndërsa punimet e Grupit të revizionimit të ISBD janë ndërprerë pasi egzistojnë një seri ideologjish të kundërta, por egziston edhe dëshira për të arritur në komunikimin e ISBD të reja të bazuara rreth standards RDA (*Resource Description and Access*) dhe FRBR (*Functional Requirements of Bibliographic Records*).

Vendndodhja në Bibliotekë: BR 6A 4

***Zhvillimi i përmbledhjeve : e kaluara, e tashmja, e ardhmja : evoluzioni i shpejtë i njërës nga funksionet kritike të bibliotekës përcakton nevojën e strategjive të reja dhe të teknologjive të përshtatshme / Rossana Morriello**

në: *Biblioteche oggi, vol. 23 (tetor 2005), nr. 8, fq. 9-18.

Në të shkuarën *zhvillimi i përmbledhjeve librare* ishte një aktivitet bibliotekar që konsumohej në praktikën e seleksionimit dhe blerjes finale të një dokumenti.

Me rënien e financimeve dhe ardhjen e burimeve digjitale, zhvillimi i përmbledhjeve librare ka pësuar një ndryshim të ngadalshëm, progresiv dhe radikal me pasojë riorganizimin e proceseve të

plota dhe të flukseve të punës në brendësi të bibliotekës. Kështu veprimet klasike të seleksionimit, blerjes, katalogimit librar – në një kohë të praktikuar në sektorë të ndryshëm të bibliotekës – tani koordinohen dhe procedohen sipas një procesi të vetëm.

Nga faza e koordinimit është kaluar në integrimin e këtyre veprimeve në një aktivitet të vetëm falë mbështetjes së sistemeve informative novative, software komplekse, që drejtojnë në një moment të vetëm, seleksionimin dhe blerjen e dokumentave dhe në fund katalogimin bibliografik të tyre (*One-stop selection, ordering and cataloguing*).

Vendndodhja në Bibliotekë: BR 6A 4

***Koleksionet nuk jetojnë më këtu?: konservimi dhe strategjitë e bashkëpunimit në tranzicion**

/ Tommaso Giordano

në: *Biblioteche oggi, vol. 24, (mars 2006), nr. 2, fq. 90-102.

Përballë drejtimin të përmbledhjeve librare (të shtypura dhe digjitale), biblioteka ka si detyrë institucionale të përshtasë politika që të synojnë krijimin e një pasurie librare për gjeneratat e ardhshme, të transmetojë njohuritë si dhe të ruajë memorijen historike lokale.

Politikat ambicioze kërkojnë pjesëmarrjen aktive të aktorëve të ndryshëm të botës së informacionit për krijimin e projekteve të bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar.

Eksperiencat në këtë drejtim janë të shumta dhe të gjitha janë të orientuara kryesisht në dy drejtime: *depozita kooperative të dokumentave dhe arkivimi digjital për një periudhë afatgjatë*. Në të dy rastet bëhet fjalë për krijimin e depozitave fizike (magazina) ose virtuale (server dhe banka të dhënash) për të përmbledhur koleksionet e subjekteve të ndryshme që marrin pjesë në projekte.

Cilado qoftë zgjidhja e përshtatur, paraqiten një seri problemesh në lidhje me modelin e drejtimin të depozitave (model qëndror ose model i shpërndarë), me sasinë e madhe të materialeve të depozituara dhe me veprimet legale në lidhje me copyright.

Vendndodhja në Bibliotekë: BR 6A 4

***Statistika të përdorimit të burimeve elektronike: disa marrëdhënie në konfrontim / Maria Cassella**

në: *Biblioteche oggi, vol. 24, (janar-shkurt 2006), nr. 1, fq. 48-61.

Prej pak kohësh bibliotekat po eksperimentojnë praktikatat dhe instrumentat e matjes sasiore për të racionalizuar drejtimin e koleksioneve.

Në të kaluarën botues të mëdhenj elektronikë, të shtyrë nga arsye tregëtare, ishin të vetmit që realizonin *reports* statistikore për rritur shitjet e burimeve në distancë të bibliotekave, ndërsa në kuadrin bibliotekar matjet statistikore në përdorimin e burimeve në distancë hasnin vështirësi si për arsye të karakterit ekonomik ashtu edhe për arsye tekniko-praktike. Në kuadrin italian konsorciumet bibliotekare dhe sistemet bibliotekare të Ateneo-s po eksperimentojnë aplikimin e një seri sondazhesh statistikore për të matur shkallën e përdorimit në distancë të burimeve elektronike (*RER*).

Eksperiencat e ndryshme individuale të botuesve dhe strukturave bibliotekare, kanë kontribuar në rritjen kaotike të një seri treguesish statistikore dhe linja guida që me vështirësi rezultojnë të normalizuar.

Ka ardhur momenti të sistemohet kjo situatë duke kërkuar të bashkëpunohet për të arritur në programimin e një standarti ndërkombëtar për krijimin e reports statistikore rreth përdorimit në distancë të burimeve.

Vendndodhja në Bibliotekë: BR 6A 4



MONOGRAFI

***Kërkimet bibliografike në rrjet : udhëzime përdorimi** [burim elektronik] / Fabio Metitieri, Riccardo Ridi. – 3. ed. riveduta e aggiornata. – Roma ; Bari : Laterza, 2004.
<http://www.laterza.it/bibliotecheinrete/>

Treguesi: * *Kërkimet bibliografike* * *Information retrieval: instrumenta e strategji* * *Opac e biblioteka virtuale* * *Botë* * *Bibliotekat e Opac në Itali* * *Bibliotekat e Opac evropianë* * *Bibliotekat dhe Opac-ët amerikanë* * *Opac të specializuar, arkiva e muze* * *Përveç katalogëve: tekstet* * *Banka të dhënash: arkivat dhe host computer në Internet* * *Metaburime të përgjithshme dhe informacione për bibliotekarët*

Kërkimi bibliografik është kompleksi i aktiviteteve të zhvilluara për të verifikuar egzistencën dhe për të patur akses në përmbajtjen informative të një tërësie dokumentash me karakteristika të caktuara, të përcaktuara herë pas here nga interesat dhe nga objektivat e vet kërkuesit.

Përdoruesit finalë të burimeve informative dhe të “mediatorëve” (bibliotekarë, bibliografë të zgjedhur për krijimin e sistemeve informative) përdorin dy tipologjitë e burimeve bibliografike: *bibliografitë* dhe *katalogët*.

Me përhapjen e Internetit dhe me lindjen e instrumentave të rinj operativë janë krijuar sisteme për të mundësuar aksesin në rrjet të çdo tipi burimesh, përfshirë gati totalin e atyre të interesit bibliografik. Aplikimi i Internetit në katalogun e automatizuar të një biblioteke ka krijuar zanafillën e OPAC (*On line Public Access Catalogue*).

Ai që ishte një akses i thjeshtë on-line në një katalog, është transformuar më pas në diçka akoma më të përcaktuar, në aksesin edhe të një biblioteke – e quajtur ndryshe “virtuale”, “jomateriale” ose “pa mure” - e rreth shërbimeve virtuale.

Në Internet rritja e katalogëve dhe e bibliotekave digjitale ka lejuar nisjen e një seri projektesh për krijimin e tipologjive të ndryshme të *katalogëve kolektivë elektronikë* (Opac kolektivë të integruar, Opac kolektivë të akumuluar etj.) dhe repertore kombëtare e ndërkombëtare të bibliotekave dhe të OPAC-ve.

Këtyre instrumentave bibliografikë të gjeneratës së fundit u bashkohen mjete të tjera kërkimi më të përgjithshme si *tregues të World Wide Web* (Tregues Web në bazë të fjalës, në bazë të argumentave; Tregues Web retrospektivë), *Meta-treguesë* dhe *Portale* që tentojnë të rregjistrojnë dhe të katalogojnë tërë përmbajtjen informative të pranishme në Internet.

***Shërbimet e informacionit për publikun : marrëdhëniet me përdoruesin në një bibliotekë miqësore** / Carla Leonardi. – Milano : Editrice bibliografica, [2000]. – 213 fq. ; 21 cm.

TREGUESI: * *Centralizimi i përdoruesit* * *Të informosh dhe të komunikosh* * *Dialogu bibliotekar-përdorues* * *Teknika e dialogut* * *Dialogu miqësor* * *Kërkimi i informacionit* * *Shënime të management* * *Cilat shërbime informimi* * *Shtojcat*

Studimet biblioekonomike më moderne në kuadrin e shërbimeve të informacionit ndaj publikut, e konsiderojnë aktivitetin e *reference* një proces të vërtetë komunikimi.

Thelbi i këtij procesi është përfaqësuar nga marrëdhënia reciproke midis përdoruesit dhe bibliotekarit që konfigurohet si një “*negociativë e problemit*” e lindur nga mungesa e njohurive nga ana e përdoruesit rreth një argumenti të caktuar.

Mungesa e njohurive përbën një nevojë informative që përdoruesi plotëson duke i përshkruar

bibliotekarit diçka që nuk di. Intervista e përdoruesit me një seri pyetjesh lejon të përcaktohet qartë nevoja informative reale e vetëm atëherë bibliotekari mund të kalojë në fazën e mëpasshme që është përcaktimi i burimeve të sistemit informativ bibliotekar më të nevojshme për përdoruesin. Kështu kalohet në fazën e kërkimit të informacionit.

Është e mundur të përdoren taktika që lejojnë të lehtësojnë kërkimin në terma të efikasitetit dhe efijencës dhe ofrojnë zgjedhje për të përballuar fazat e bllokimit në kërkimet komplekse.

Vendndodhja në Bibliotekë: BM 71D 38a

***Linjat guida IFLA/UNESCO për bibliotekat shkollore /** edicioni italian nën kujdesin e Komisionit kombëtar të bibliotekave shkollore të AIB (Shoqata e Bibliotekave Italiane); koordinim e revizionim i Luisa Marquardt e Paolo Odasso ; hyrja nën kujdesin e Luisa Marquardt, Paolo Odasso. – Roma : Shoqata e Bibliotekave Italiane, 2004. – 125 fq. : ill. ; 21 cm.

TREGUESI: * *Synimi institucional dhe politikat e drejtimit* * *Burimet* * *Personeli* * *Programi dhe aktiviteti* * *Promovimi i bibliotekës dhe kuptimi* * *Shtojca e edicionit italian*

Përballë rritjes eksponenciale të informacioneve, shkolla dhe biblioteka shkollore kanë një detyrë edukative shumë të rëndësishme, detyrën e transmetimit ndaj docentëve dhe studentëve të një seri kopetencash informatike dhe informative për të përdorur informacionet dhe teknologjitë e reja në mënyrë korrekte dhe të përgjegjshme.

Për të arritur këto objektiva, biblioteka shkollore përcakton një politikë të saktë veprimesh e cila deklaron ofertën formative, metodat e kuptimit, kriteret për të stabilizuar nevojat e kuptimit të studentit dhe kriteret e sadsifaksionimit të interlekutorëve të ndryshëm.

Figura e bibliotekarit shkollor merr një rol të rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme: drejton strukturën nëpërmjet një menaxhimi efikas të burimeve të ndryshme, promovon shërbimin bibliotekar në brendësi të shkollës nëpërmjet përgatitjes së planit të marketingut, zhvillon aktivitete trajnimi për studentët, stabilizon kriteret për monitorimin dhe vlerësimin e *performance* të bibliotekës për t'u siguruar që politikat e përdorura po arrijnë objektivat e deklaruar.

Vendndodhja në Bibliotekë: BM 71D 36a

***Çfarë është një bibliotekë /** Gabriele Mazzitelli. – Roma : Carocci, c2005 (stampa 2006). – 128 fq. ; 20 cm.

TREGUESI: * *Koncepti i bibliotekës* * *Situata italiane* * *Drejtimi i një biblioteke* * *Katalogu, integrimi i burimeve dhe shërbimi i informacionit* * *Shërbimet* * *Biblioteka në rrjet* * *Probleme e prespektiva* * *Shtojca* * *Fjalori*

Rritja e burimeve elektronike ka kontribuar në afirmimin e një modeli të ri të bibliotekës, modeli *hibrid*, në të cilin bashkëjetojnë aspektet tradicionale dhe ato novative të drejtimit bibliotekar. Kështu gjejmë pranë dokumentave të shtypur, dokumenta elektronikë e digjitalë, pranë një strukture fizike egziston dimensionin virtual i bibliotekës digjitale. Shtohet këtu edhe rinovimi i rolit të institucionit bibliotekar i cili nga qendër e informacionit lokal kthehet në një nyjë e një rrjeti të gjerë informativ. Në këtë fazë tranzicioni, biblioteka moderne gjendet përballë problemeve të reja dhe skenarëve të papublikuar në lidhje me drejtimin e burimeve (budgets dhe instrumentave katalografikë), të shërbimeve (konsultimi i materialeve elektronikë, huatë, rekuperimi i informacioneve nëpërmjet shërbimeve ILL e DD, riprodhimi i dokumentave) dhe të Web-it.

Vendndodhja në Bibliotekë: BM 71 E 1a

***Njohuritë e bibliotekarit / Michel Melot. – Milano : Sylvestre Bonnard, c2005 (stampa 2006). – 94 fq. ; 21 cm.**

TREGUESI: * *Si një marinar në mes të oqeanit* * *Mangësi të pranueshme* * *Vendi i marrëdhënieve* * *Universi i bibliotekës* * *Gjetët çfarë kërkonit?*

Zotësia e bibliotekarit identifikohet me një seri kompetencash e njohurish të cilat lejojnë menaxhimin e njëkohshëm të aspekteve të ndryshme profesionale: të objekteve (libra e përmbledhje librare), të subjekteve (përdoruesit, drejtuesit, administratorët) dhe të hapësirave fizike e virtuale të një biblioteke moderne.

Bibliotekari kthehet kështu në një *arkitekt shumëformësh* të vërtetë. Si arkitekt i infrastrukturave të njohurive ai analizon librin, kupton përmbledhjen tekstuale me synim përhapjen nëpërmjet përgatitjes së instrumentave të përshtatshëm katalografikë.

Bibliotekari është edhe arkitekt i përmbledhjeve librare sepse realizon fonde të përshtatshme librare për publikun e vet duke mos akumuluar të gjitha veprat e prodhuara dhe të propozuara nga botuesit, por duke bërë një seleksionim të librave e duke marrë përsipër edhe përgjegjësitë që mund të rrjedhin nga një aktivitet çensure.

E në fund zotësia e tij i lejon të bëhet ideatori i hapësirave fizike, i strukturave të përshtatshme për të konservuar përmbledhjet librare, për të grumbulluar përdoruesit dhe aktivitetet e ndryshme që normalisht zhvillohen në bibliotekë.

Vendndodhja në Bibliotekë: BM 71 E 3a

***Bibliotekat institucionale në sistem : sondazh rreth rolit të Këshillave rajonale dhe të Provincave autonome / nën kujdesin e Pier Giorgio Tiozzi. – Venezia : Consiglio regionale del Veneto : CIERRE, [2005]. – 143 fq. ; 21 cm.**

TREGUESI: * *Hyrje në punime* * *Marrëdhëniet: *Modifikime strukturale nga 1998 në 2003: (metodologjia e sondazhit dhe rezultatet)* * *Burimet në fondet e bibliotekave* * *Pyetje të shprehura nga përdoruesit* * *Shërbime të prodhuara nga bibliotekat* * *Roli i bibliotekave institucionale dhe linjat evolutive* * *Ndërhyrjet* * *Përfundimet* * *Shtojca 1. Përpunimet* * *Shtojca 2. Referime*

Bibliotekat e Këshillave Rajonale të Italisë marrin një funksion shumë të rëndësishëm në përhapjen e informacioneve dhe të njohurive pasi janë institucione kulturore speciale për përdoruesit e tyre, për materialet dokumentuese që posedojnë dhe për detyrat që duhet të kryejnë.

Këto biblioteka largohen nga Qendra dokumentimi për Këshillat duke ofruar një mbështetje të vlefshme në aktivitetet legjislativ të zhvilluara nga Institucionet politike nga të cilat varen; në të njëjtën kohë janë edhe biblioteka publike pasi ofrojnë të njëjtat shërbime edhe për publikun e jashtëm.

Një sondazh i realizuar nga një grup pune i Bibliotekës dhe Qendrës së dokumentimit të Këshillit Rajonal të Veneto-s lejon të kuptohet se si veprojnë bibliotekat e ndryshme rajonale dhe cila është shkalla e produktivitetit të tyre.

Studimi nuk ka si objektivi hartimin e një klasifikimi të bibliotekave, por shërben për përcaktimin e aspekteve strategjike të drejtimit (burime e shërbime), të cilat të organizuara me efikasitet, do t'u lejonin bibliotekave më pak të përshtatshme të marrin një itinerar rritjeje graduale që do t'i çonte në të njëjtin nivel me bibliotekat e tjera.

E gjithë kjo, bëhet një hyrje e rëndësishme, për të realizuar një projekt të vlefshëm bashkëpunimi midis bibliotekave të Këshillave Rajonale të ndryshëm të Italisë.

Vendndodhja në Bibliotekë: BM 71 E 2a

***Historia e bibliotekave në Itali : nga Unifikimi i Italisë deri më sot / Paolo Traniello ; me materiale të përpunuara nga Giovanna Granata, Claudio Leombroni, Graziano Ruffini. – Bologna : Il Mulino, c2002 (stampa 2004). – 530 fq. ; 21 cm.**

TREGUESI: (Pjesa e parë) * Struktura e kuadrit institucional: * Bibliotekat si pasuri kombëtare * Moshë e rregulloreve * Dualizmi bibliotekar në periudhën e Giolitti-t * Periudha fashiste * Lindja e bibliotekave publike në Itali * Ndër të mirat kulturore dhe autonomitë lokale. Bibliotekat italiane sot (Pjesa e dytë)* Çështje dhe prespektiva: * Depozita legale * Shërbimi bibliotekar kombëtar. Ide, pasione, historia * Bibliotekat e universiteteve italiane * Refleksion shkencor

Një rikostruktim i përpiktë i historisë së bibliotekës italiane nga Unifikimi i Italisë deri më sot na jep një kuadër institucional kompleks i mbetur gati i pandryshuar në harkun e 150 viteve.

Pas Unifikimit të Italisë, Shteti italian trashëgon nga monarkitë e kaluara një pasuri shumë të madhe institucionesh dhe përmbledhjesh librare të konsideruar ndër më të pasurat në botë, por për një seri problemesh të natyrës politike, administrative, legjislativ dhe ekonomiko-kulturore nuk ka qënë e mundur të realizohet një kuadër uniform.

Sistemi bibliotekar kombëtar aktual tregon shenja të një politike të pavazhdueshme dhe kontradiktore: një dualizëm historik midis bibliotekave publike shtetërore dhe bibliotekave publike të enteve lokale i shënuar nga një superioritet i pajustificueshëm i të parave ndaj të dytave; një sistem bibliotekar kombëtar fortësisht i centralizuar përballë një modeli të decentralizuar i pavënë plotësisht në funksion; mungesa e një aparati organik legjislativ që të disiplinonte tërësisht sistemin e bibliotekave; e në fund një model biblioteke të ancoruar në konceptin tradicional të vendit të konservimit, sesa ai novativ i shërbimit kulturor për publikun.

Këto janë shenja konkrete të të kaluarës të cilat kanë penguar për gati 150 vjet afirmimin e modelit anglosakson të bibliotekës publike (*public library*).

Vendndodhja në Bibliotekë: BM 71 E 4a

***Menaxhimi i ndryshimit: metodologji të reja për management të bibliotekave / nën kujdesin e Giovanni Solimine. – Milano : Editrice bibliografica, [2003]. – 385 fq. ; 21 cm.**

TREGUESI: * Bibliotekonomia dhe management * Planifikimi i shërbimeve * Të mendosh, të punosh për projekte * Bibliotekat drejt web marketing * Modele e instrumenta për vlerësimin

Biblioteka moderne është një institucion që ofron shërbime informacioni, konsultimi dhe leximi në përgjigje dhe sadsifikacion të nevojave të përcaktuara të publikut të vet. Në këtë këndvështrim biblioteka është e hapur ndaj rreziqeve të ndryshme në lidhje me ndryshimin e papritur të ambienteve të jashtme: disorientime gjatë drejtimit, objektiva të përealizuar, politika drejtuese pak efektive etj....

Në këto raste duhen adoptuar një seri masash që garantojnë përshtatjen konstante të sistemit bibliotekë ndaj nevojave të përdoruesve. Kështu management bibliotekar duhet të impenjohet në: adoptimin e *modeleve organizative fleksibile* të lehta për t'u riprojektuar; në vënien përkrah drejtimit të proceseve drejtimit të *projekteve*; në adoptimin e një *plani marketing të tipit të marrëdhënies one-to-one* për të konsoliduar edhe në Web marrëdhëniet me përdoruesit dhe për të personalizuar shërbimet e ofruara; e në fund në matjen dhe vlerësimin e vazhdueshëm të performancave të shërbimit.

Disiplinat drejtuese kombinohen shumë mirë me shkencat biblioekonomike dhe së bashku i garantojnë bibliotekës rezultate të rëndësishme ekikasiteti dhe efijence.

Vendndodhja në Bibliotekë: BM 71 D 42a

***Itinerare të cilësisë në bibliotekë** / Giovanni Di Domenico. – Manziana (Roma) : Vecchiarelli, [2002]. – 148 fq. ; 21 cm.

TREGUESI: * *Praktika të cilësisë dhe karta e shërbimeve në bibliotekë* * *Vlerësimi i cilësisë në bibliotekat universitare* * *Normativa e re ISO 9000 midis sadsifaksionimit të klientit dhe çertifikimit* * *Biblioteka njuh: cilësinë organizative dhe cilësinë e shërbimit në shoqërinë e njohurive* * *Cilësia e bibliotekave publike në bashkëpunimin ndërbibliotekar* * *Customer relationship management i bibliotekës: nga sadsifaksionimi i klient/përdorues-it në krijimin e besueshmërisë së tij* * *Vlerësimi i kapitalit njerëzor: situata ekonomike e profesionale, kopetencat dhe funksionet e bibliotekarëve në Universitete* * *Probleme e prospektiva të bibliotekonomisë në Itali (Shtojca)*

Për bibliotekat të cilat dëshirojnë të hyjnë në rrugën e Cilësisë janë në dispozicion instrumenta pune të cilët mund të ndihmojnë në krijimin e një sistemi drejtues të cilësisë:

- *Measuring quality* i publikuar në 1996 nga IFLA (International Federation of Library Associations);
- Paketa e re e normave ISO 9000, e quajtur “*Vizion 2000*”;
- *Linjat guidë për redaktimin e kartës së shërbimeve për bibliotekat publike*, të përpunuara nga Komisioni kombëtar i bibliotekave publike.

Por praktikimi i Cilësisë në bibliotekë nuk do të thotë vetëm respektim të normave teknike, do të thotë edhe një vëmendje e veçantë drejt të gjithë komponentëve jomaterialë të cilët bashkëpunojnë në krijimin e shërbimit si: *kapitali njerëzor, kapitali intelektual, marrëdhëniet me lexuesit dhe bashkëpunimi*.

Vendndodhja në Bibliotekë: BM Direttore

Shënime të përmbajtjes

Buletini është një përmbledhje abstraktesh të botimeve shqiptare që i përkasin fushave të albanologjisë dhe të bibliotekonomisë, te ndara në dy seksione: *albanologji dhe bibliotekonomi*. Secili prej këtyre seksioneve përmban nëndarje të tjera, të cilat përmbajnë botime të kohëve të sotme ose të alternuara.

Në këtë numër:

1. Seksioni i Albanologjisë:

- Kërkime bibliografike mbi studimet historike dhe arkeologjike;
- Kërkime bibliografike mbi studimet filologjike;
- Kërkime bibliografike mbi trashëgiminë popullore shqiptare;
- Kërkime bibliografike mbi studimet e artit dhe të kulturës shqiptare

2. Seksioni i Bibliotekonomisë:

- Historiku i bibliotekave shqiptare;
- Komunikimi elektronik në biblioteka;
- Informatizimi i bibliotekave në Shqipëri;
- Menaxhimi i proceseve në biblioteka;
- Menaxhimi i koleksioneve në biblioteka;
- Përdorimi i bibliotekave;

Biblioteka e Akademisë së Shkencave është krijuar në vitin 1975, pikërisht 2 vjet pas themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kjo Bibliotekë lindi si nevojë imediate e Akademisë së Shkencave dhe e instituteve të saj albanologjike dhe kërkimore-shkencore, për të plotësuar kërkesan e domosdoshme për zhvillimin e tyre shkencor: atë të informimit dhe furnizimit me literature shkencore e bashkëkohore. Gjatë viteve të ekzistencës së saj, Biblioteka e Akademisë së Shkencave është pasuruar me materiale të ndryshme, me botime albanologjike dhe literature teknike e shkencore, nga të gjitha fushat që mbulojnë institutet dhe qendrat e saj kërkimore-shkencore e më gjerë.

Buletini që po paraqesim, përmban një përzgjedhje të kësaj literature, që janë fond i pasurisë së kësaj biblioteke. Përzgjedhja e literatures i përket fushave të albanologjisë dhe të bibliotekonomisë.



SITE NE INTERNET

***Gjuha shqipe dhe kompjuteri**

<http://www.gjuha-shqipe.com>

Kështu quhet projekti i ndërmarrë nga Qendra për Edukim dhe Përparim (QEP) në Prishtinë në bashkëpunim me gjuhëtarë nga Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës.

Projekti përqendrohet në tri aspekte kryesore: organizativ, gjuhësor dhe programues. Në fazën e parë të këtij projekti, që u përfundua këto ditë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, përfshihet: *Programi AS 2.0*, për drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Programi është një pako profesionale softueri që siguron në mënyrën më të mirë korrigjimin drejtshkrimor të një teksti shqip sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Programi "Kulla e shqipes", mundëson përvetësimin e strukturës gramatikore të gjuhës shqipe. Përmban të gjitha format morfologjike të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës (format e lakimit të emrave dhe të zgjedhimit të foljeve).

FESH – Fjalori elektronik shpjegues, do të vendoset për shkarkim këtë vit nga kjo faqe interneti.

Libri elektronik ofron mundësinë e leximit të veprave të shkruara të dixhitalizuara, të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Ndihej sidomos fëmijët e emigrantëve shqiptarë që të mos harrojnë gjuhën shqipe. Do të vendoset së shpejti për t'u shkarkuar në këtë faqe interneti.

Windows-i shqip. Bëhet fjalë për Microsoft Windows XP, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të redaktuar nga ana gjuhësore.

Në këtë faqe interneti gjenden gjithashtu studime për gjuhën shqipe si : dokumentet e para të shqipes së shkruar, historiku i gjuhës shqipe, gramatika, standardizimi etj.

***Robert Elsie : writer, translator, interpreter, specialist in Albanian studies**

<http://www.elsie.de/>

Ky është website i Robert Elsie (lindur më 1950 në Vankouver, Kanada). Këtu gjenden informacione rreth atij vetë, dhe në mënyrë të veçantë jepen pothuajse të gjitha botimet e tij si libra, artikuj revistash, intervista etj. që nga viti 1975 e deri më sot, teksti i plotë i të cilave mund të shkarkohet nga kjo faqe interneti ne PDF file.

Robert Elsie ka fokusuar, në pjesën më të madhe të botimeve të tij, kulturën, letërsinë dhe historinë shqiptare. Në këtë website përfshihen:

"Autorët e përkthyer shqiptarë", përmban një zgjedhje të gjerë të letërsisë shqiptare nga autorë të së shkuarës dhe të së tashmes nga Shqipëria, Kosova dhe diaspora shqiptare, disa prej të cilave janë të përkthyer për herë të parë.

"Tekste dhe dokumente të historisë shqiptare", jep një histori të shkrimeve të para të gjuhës shqipe, duke filluar që nga shek.XI-XII, gjë që veç të tjerash, ndihmon për të kuptuar historinë dhe zhvillimin e Shqipërisë e të popullit shqiptar dhe do të nxisë ndërmarrjen e studimeve të tjera në këto fusha. Këtu përfshihen reportazhe të udhëtarëve dhe kronikanëve të huaj, që kanë vizituar Shqipërinë e atyre viteve.

***Shqipëria.com**

<http://www.Shqipëria.com>

Web site Shqipëria.com filloi të ofrojë shërbimet e saj në fund të vitit 2001. Sot ky shërbim u ofrohet afër 300 web site-ve shqiptare në internet, duke mundësuar prezencën e tyre në linjë.

Faqja web është strukturuar në seksione të ndryshme, secila prej tyre, i lejon vizitorit virtual të nxjerrë dokumente dhe informacione që kanë të bëjnë me: Trashëgiminë kulturore shqiptare (nxjerre nga Guida “Shqipëria një trashëgimi e vlerave europiane”, një kopje e versionit të saj original është publikuar edhe në internet në web site: www.albanianculturalheritage.com); Arkeologjinë (ku flitet për interesimin e studiuesve të huaj për vlerat arkeologjike të Shqipërisë, për kërkimet dhe studimet që kanë bërë arkeologët shqiptarë mbi prehistorinë, antikitetin dhe mesjetën e hershme); Besimet fetare; Gjuha shqipe (origjina, dialektet, alfabeti, standardizimi i gjuhës shqipe etj.); Artet e bukura (që nga fillimi dhe zhvillimi i tyre deri në ditët tona); Fotografia shqiptare; Kodikët e Shqipërisë; Eposi i Shqiptarëve (Eposi i Kreshnikëve); Kultura tradicionale; (mënyra e jetesës, vendi i banimit, mitet dhe besimet popullore, arti dhe artizanati popullor , veshjet etj.); Letërsia shqiptare (historia e letërsisë shqiptare dhe disa prej shkrimtarëve më të shquar në shekuj); etj.



REVISTA

***Komunikimi elektronik i bibliotekave, standartet përkatëse / Behije Luga**

Në: *Bibliothecae, 2003, nr. 4, f. 111-118.

Automatizimi dhe kooperimi ndërbibliotekar varet shumë nga standartet e përshkrimit, organizimit dhe prezantimit të dokumenteve, si dhe nga standartet e hardit, softit dhe të telekomunikacionit që mbështesin sistemet e sotme.

Artikulli përqëndrohet kryesisht në llojet e standarteve ndërkombëtare që përdoren sot në bibliotekë në kuadrin e teknologjive të reja. Zbatimi i standarteve është nyja që bashkon infrastrukturën e informacionit dhe mundëson operime të ndërsjellta midis sistemesh të ndryshme informacioni të futura në rrjet. Jepen gjithashtu dhe informacione për grupet dhe organizatat përgjegjëse për standartizim.

Programi i Bibliotekave të Komisionit Evropian ka dhënë një kontribut të madh për zhvillimin dhe testimin e standarteve në përgjithësi dhe të standarteve teknike në veçanti.

Numri i vendit në bibliotekë: 05:027.54 B 534

***A e ka njohur Budi librin e Buzukut? / Shaban Demiraj**

Në: *Dija, 2005, nr. 3, f. 31-36.

Çështja që shtrohet është e lidhur ngushtë me pyetjen nëse botimi i librit të Gjon Buzukut, si i pari botim i njohur në gjuhën e shkruar shqipe (1555), ka luajtur ndonjë rol në lëvrimin e mëtejshëm të kësaj gjuhe. Kjo ka të bëjë me historinë e shkrimit të gjuhës shqipe, e cila mesa duket nuk është sqaruar përfundimisht, për mungesë të dhënash të drejtpërdrejta. Po kështu sqarohet vendi i botimit të librit të Buzukut, përhapja që ai ka pasur dhe mbështetja nga Kisha Katolike.

Përsa i përket vendit të botimit të librit, studiuesit paraqesin mendime të ndryshme, ndër të cilat më i pranueshmi është ai që, shtypshkronja ku u botua libri duhej të ndodhej pranë famullisë ku Buzuku shërbente si prift. Libri i Buzukut ka qenë lexuar nga një numër jo fort i vogël njerëzish, megjithëse librat e këtij tipi ishin të destinuar kryesisht për priftërinjtë. Ai gjithashtu ka pasur mbështetjen e autoriteteve eprore kishtare, për vetë faktin se Kisha Katolike në atë kohë, mbante një qëndrim inkurajues ndaj botimit të librave fetarë në gjuhën shqipe. Por pyetjes nëse e kanë njohur atë shkrimtarët fetarë veriorë që erdhën pas Buzukut, është vështirë t'i jepet një përgjigje e prerë. Megjithatë, shqyrtimi i hollësishëm i veprave të Budit tregon përafritë në veprat e këtyre autorëve në alfabetin e përdorur, drejtshkrim (mënyra e shënjimit të zanoreve të gjata) etj. Kjo e fundit të bën të mendosh për një traditë shkrimi të gjuhës shqipe edhe më të vjetër se Buzuku. Në përfundim, mendohet që Budi duhet ta ketë njohur librin e Buzukut dhe të jetë ndikuar prej tij.

Numri i vendit në bibliotekë: 05: 008 D 414

***Periudha e realizmit dhe e modernitetit bashkëkohor në letërsinë shqipe : vitet '30-'90-të të shek. 20.** / Bashkim Kuçuku

Në: *Studime Filologjike, 2005, nr. 1-2, f. 5-27.

Vepra bën fjalë për rëndësinë e madhe teorike dhe praktike të periodizimit, në studimin e historisë letrare shqipe. Kohështrirja e periudhës duhet mbështetur tek ndryshimi i përbërësve të brendshëm të letërsisë si ndryshimi i temave, i gjinive, i strukturave, i stileve dhe i vetë gjuhës.

Periudha e realizmit në letërsinë shqipe fillon në vitet'30 të shek.XX, po kështu dhe mendimi teorik dhe krijimtaria realiste. Më pas vijon realizmi socialist, që dominoi gjatë 50 viteve. Megjithatë në këtë periudhë vihet re një krijimtari realiste e pasur në romane, tregime dhe poezi, pavarësisht nga mbikëqyrja rigorozë e censurës së realizmit socialist, i cili s'ishte gjë tjetër veçse një hibrid ideologjik i modelit realist.

Ndërsa periudha e modernitetit bashkëkohor së bashku me konceptet, krijimtaritë, strukturat dhe stilet e saj (vitet'50-'90), është shfaqur qëkur realizmi ende nuk ishte formësuar. Në këtë periudhë është shkruar një krijimtari e tërë me cilësi të reja, që ndryshonte rrënjësisht prej krijimtarisë realiste dhe në kundërshtim të plotë me realizmin socialist. Letërsia shqipe ishte njëhërësh moderne dhe bashkëkohore, por që ndryshonte në tematikë nga letërsia e vendeve evropëndimore, për shkak të ndryshimeve të realiteteve shoqërore. Në romanin shqiptar modern dhe bashkëkohor mbizotëron simbolika dhe alegorika, të cilat ndërthuren me ironinë dhe me groteskun.

Në letërsinë shqipe të viteve '30-'90, kanë bashkëjetuar vetëdije letrare, krijimtari, struktura dhe stile të ndryshme, si realizmi, realizmi socialist dhe moderniteti bashkëkohor.

Numri i vendit në bibliotekë: 05: 81 S 943

***Sfidat e pavarësisë së Shqipërisë / Arben Puto**

Në: *Studime Historike, 2003, nr. 1-2, f. 153-157.

Pavarësia e Shqipërisë ka kaluar disa sfida. Ajo përshkoi një rrugë të gjatë e të ndërlikuar përpara se të afirmohej në planin Ndërkombëtar pas Luftës së Parë Botërore, si dhe të tjera sfida gjatë Luftës së II Botërore e më pas.

Sfida e parë konsiderohet ajo e Kongresit të Berlinit, ku çështja e Shqipërisë (e cila asokohe ishte nën sundimin e Turqisë), nuk u njoh si çështje e shtruar për zgjidhje. Lidhja e Prizrenit u bë faktor përcaktues në kapërcimin e rrezikut të copëtimit të trevave shqiptare ndërmjet shteteve fqinje.

Sfida e dytë dhe e vërtetë e pavarësisë i përket viteve 1912-1913 me rikthimin e çështjes shqiptare në planin diplomatik. Në Konferencën e Ambasadorëve çështja shqiptare dhe statusi i Shqipërisë (autonomi apo pavarësi), paraqitet si një element i ri i rregullimit të situatës në Ballkan pas tërheqjes së Turqisë. Këtu u vendos njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Shqipërisë në 29 korrik 1913, megjithëse Kuvendi i Vlorës kishte shpallur pavarësinë më 28 nëntor 1912. Vihet re prirja e ndërkombëtarëve për të shmangur faktorin shqiptar në zhvillimin e ngjarjeve pas shpërthimit të Luftës Ballkanike. Konferenca e Ambasadorëve, veç të tjerave, ndau kufijtë e Shqipërisë, pa marrë për bazë parimin etnik, duke kënaqur ambicet e shteteve fqinje. Kështu, u krye padrejtësia më e madhe: gjysma e kombit shqiptar mbeti jashtë kufijve të shtetit të ri.

Sfidë tjetër e rëndë qe rishtrimi i çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve, pas mbarimit të luftës evropiane dhe Traktati i fshehtë i Londrës (që kërkonte të ricopëtonte trojet shqiptare), i cili u denoncua nga Presidenti amerikan Ëilson.

Në Luftën e II Botërore Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste dhe më pas nga Gjermania, deri në mbarim të kësaj lufte. Më pas për gati gjysëm shekulli, me vendosjen e sistemit komunist Shqipëria mbeti e izoluar nga bota evropëndimore, deri në fillim të viteve '90 me rënien e sistemit komunist.

Numri i vendit në bibliotekë: 05: 94 S 943

***Përdorimi i bibliotekave dhe qasja në informata / Gjon Berisha**

Në: *Biblioteka, Viti 2, 2005, n. 2, f. 23-33.

Artikulli vë në dukje rëndësinë që marrin në kohët e sotme bibliotekat për mbledhjen, organizimin dhe për shfrytëzimin e informacionit të shumtë e të gjithanshëm. Ky informacion duhet vene sa me pare ne dispozicion te perdoruesit nëpërmjet menyrave te ndryshme qe perdorin bibliotekat, si ato tradicionalet (katalogët në formë libri, skedash, mikrofishash) ashtu edhe nëpërmjet katalogëve elektronikë. Ky i fundit po zëvendeson perhere e më shumë kataloget tradicionale duke u bere gjithnje e me i preferuar ne saje te avantazheve qe ka dhe lehtesive ne perdorim. Përdoruesit i ofrohen mundesi te shumta zgjedhjeje, në menyra te ndryshme, dhe ne çfaredo distance nga ambientet e bibliotekes.

Numri i vendit ne bibliotekë: 05: 021.7 B 534

***Parahistoria e kërkimeve arkeologjike në Apolini / Ilir Gjipali**

Në: *Iliria, 2003-2004, nr. 1-2, f. 207-214.

Veprat e shkruara të autorëve grekë e romakë, tregojnë interesin e madh për njohjen dhe studimin e qytetërimeve të hershme, që në kohët antike. Në mesjetën e mesme dhe veçanërisht në atë të vonë, rritet ndjeshëm interesimi i kërkuesve dhe i studjuesve për qytetërimin e Ilirisë dhe sidomos te Apollonisë, gjë që vihet re duke filluar që nga autorët antikë (Herodote, Skylax, Aristotel, Ciceron, Strabon, Pline, Plutarque, Ptoleme, Dion Cassius etj.)

Arsyet e këtij interesimi për Apolloninë janë të shumta dhe të natyrshme. Ajo përfaqëson një nga qendrat antike më të mëdha e më të rëndësishme ekonomike, politike, kulturore e artistike të bregdetit lindor të Adriatikut. Gjatë periudhës njëmijëvjeçare të ekzistencës së saj arriti një nivel të lartë zhvillimi sidomos në art e kulture, gjë që vihet re dhe në vlerësimet impresionuese të personaliteteve të shquara të kohës. Edhe pas ekzistencës së Apolonisë, burime të shkruara vazhdojnë ta përmendin atë. Kështu në shek.XV, rrënojat e Apolonisë përmenden nga i mbiquajturi Cyriaque i Ankonës, gjatë udhëtimeve të tij në qendrat antike të Mesdheut, ku përmend tempullin e Dianës dhe rrënoja të tjera përreth. Pas një periudhe heshtjeje, shihet një interesim i dukshëm për Apolloninë në shek.XIX dhe ne shek.XX. Ndër studiuesit që kanë shkruar për Apolloninë (pas autorëve antikë), përmendim Pouqueville, W.M.Leake, L.Heuzey, H.Daumet, Gilleron, Karl Patsch, G.Weith, S.Casson etj.

Qyteti antik i Apolonisë kohët e fundit është shndërruar në një qendër të madhe kërkimore-shkencore nga specialistët shqiptarë dhe të huaj.

Numri i vendit ne bibliotekë: 05:902 I 309

***Bibliotekat publike dhe informacioni për bashkësinë / Tefta Buzo**

Në: *Bibliothecae, 2004, nr. 5, f. 87-92.

Bibliotekat publike përbëjnë numrin më të madh të qendrave të informacionit dhe të komunikimit. Ato janë në shërbim të bashkësisë dhe kanë përgjegjësi të veçantë në mbledhjen dhe organizimin e burimeve të informacionit me karakter lokal. Plotësimi i kërkesave të bashkësisë për informacion lidhet me njohjen e interesave të përdoruesve. Mbi këtë bazë, bibliotekat ndërtojnë punën e tyre për pasurimin e koleksioneve, ruajtjen dhe përdorimin e materialeve me vlera historike dhe të traditave të bashkësisë si edhe të informacionit lokal. Organizimi i koleksionit të referencave dhe seleksionimi i materialeve që kanë të bëjnë me bashkësinë është një ndihmë e madhe për përdoruesit në dhënien e informacionit që atyre u nevojitet. Kooperimi i bibliotekave publike me institucionet e tjera si arkivat, muzeumet etj., është një rrugë tjetër e dobishme në ndihmë të studjuesve të bashkësisë.

I rëndësishëm është krijimi në disa qytete i qendrave të informacionit për bashkësinë.

Numri i vendit ne bibliotekë: 05:027.54 B 534



MONOGRAFI

***Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare : M. Barleti, G.J. Buzuku, P. Budi, F. Bardhi, P. Bogdani / Zija Xholi. – Tiranë : Shkenca, 2003. - 202 f.; 22 cm.**

PASQYRA E LËNDËS: **Parathënie * Marin Barleti (1450-1512) * Gjon Buzuku (1555) * Pjetër Budi (1566-1623) * Frang Bardhi (1606-1643) * Pjetër Bogdani (1630-1689) * Pashënie*

Afirmimi i kombësisë shqiptare dhe krijimi i kulturës kombëtare shqiptare, ka njohur një rrugë të gjatë e të mundimshme. Në përpjekjet e bëra nga mendimtarët dhe atdhetarët shqiptarë, vendin qendror dhe interesin e veçantë e ka zënë puna për të mbërritur në gjuhën e shkruar shqipe me të gjitha komponentët e saj: alfabet, drejtshkrim, morfologji, leksik, etj.

Vatra e parë e përpjekjeve për gjuhën e shkruar është Shqipëria Veriore e shekujve 16-të e 17-të me pesë personalitetet e shquar të kulturës kombëtare shqiptare: Marin Barleti, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani.

Interesi dhe përpjekjet për të arritur në gjuhën e shkruar shqipe nuk ka qenë diçka e rastit. Ato ishin kërkesë imperative e kohës që lidhej me dy momente kryesore: së pari me një *moment kombëtar*, sepse gjuha është kusht kryesor për ekzistencën e kombit dhe të ndërgjegjes kombëtare. Së dyti me një *moment kulturor*, sepse kultura është e lidhur aq ngushtë me gjuhën e shkruar, sa që pa gjuhë të shkruar, nuk ka kulturë, art, shkencë, dituri.

Ndihmesën historike në fushën e gjuhësisë shqiptare të këtyre mendimtarëve e kanë njohur dhe çmuar mjaft studjues dhe shkencëtarë të huaj e shqiptarë. Sa rëndësi ka gjuha e shkruar në këto vepra, po aq ka dhe përmbajtja ideore e intelektuale e tyre. Vendin e parë në to e zë ana shpirtërore, kishtarë, të cilës i janë kushtuar të gjitha veprat e shkruara, duke filluar me “Mesharin” e Gjon Buzukut, dhe deri te “Çeta e profetëve” e Pjetër Bogdanit. Veprat e tyre kanë rëndësi edhe në drejtime të tjera siç është kultura laike dhe ajo kombëtare. Në të gjitha këto vepra ata janë aq shumë mbrojtës të besimit të krishterë sa dhe atdhetarë të zjarrtë të çështjes shqiptare. Ata vlerësonin lart kulturën e lashtë greko-romake dhe mendimtarët e saj, duke u përpjekur të fusin edhe kulturën e re kombëtare shqiptare në rrjedhat e kulturës evropiane, të humanizmit dhe të Rilindjes së saj.

Numri i vendit në bibliotekë : 1 Xh 790

***Mbishkrime të kishave shqiptare / Theofan Popa ; Red. Nestor Nepravishta, Kostandin Gjakumis. – Tiranë : Shkenca, 1998. - 355 f. : il. ; 26 cm.**

PASQYRA E LËNDËS: ** Parathënie * Hyrje * Treguesi kronologjik i mbishkrimeve * I. Mbishkrime të zones së Durrësit * II. Mbishkrime të zones së Beratit * III. Mbishkrime të zones së Korçës * IV. Mbishkrime të zones së Gjirokastrës * V. Mbishkrime të zones Himarë-Delvinë * VI. Mbishkrime të zones së Shkodrës * Pashënie e redaktorëve * Treguesi i emrave të vendeve * Treguesi i emrave të njerëzve*

Burimet dokumentare të historisë mijërvjeçare shqiptare, të traditave të lashta të popullit shqiptar nuk janë të shumta, për shkak të rrethanave historike të veçanta e të vështira, në të cilat është ndodhur Shqipëria gjatë shekujve. Kështu që zbulimi, mbledhja dhe studimi i burimeve dokumentare ekzistuese historike merr një rëndësi të veçantë. Ndër këto burime dokumentare

historike, të rëndësishme janë edhe materialet e ndryshme epigrafike, për të dhënat që ruajnë që prej epokave historike më të lashta.

Materialet epigrafike më të hershme që ruhen në Shqipëri, i përkasin qendrave antike si Durrës (Dyrahium), Pojan i Fierit (Apoloni), Butrint (Buthrotos) etj. Pjesa më e madhe e mbishkrimeve mesjetare është e lidhur me kishën e krishterë dhe ruhet ndër institucionet fetare të kësaj kishe (tempuj, manastire, shpella eremite dhe varre brenda kishave ose nartekseve kishtarë dhe në objekte të ndryshme të përdorimit kishtar). Ky material gjatë shekujve ka ardhur duke u dëmtuar e duke u pakësuar, për shkaqe të ndryshme.

Botimet rreth këtyre materialeve epigrafike kishtarë të Shqipërisë janë të pakta dhe në pjesën më të madhe i përkasin shekullit të kaluar. Për këtë arsye, nxjerrja në dritë e këtij vëllimi, merr një rëndësi të veçantë. Në këtë vëllim përfshihen pothuajse të gjithë mbishkrimet që i përkasin institucioneve fetare të kultit të krishterë që gjenden brenda kufijve politikë të Republikës së Shqipërisë, ashtu dhe mbishkrimet e botuara nga autorë të tjerë vendas ose të huaj.

Numri i vendit në bibliotekë: 930.2 P 600

***Veshjet shqiptare në shekuj :** origjina, tipologjia, zhvillimi / Andromaqi Gjergji.- Tiranë : [s.n.], 2005. - 321 f. : ill. ; 25 cm.

PASQYRA E LËNDËS: * *Hyrja* * *Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri* * *Variacione të kostumeve popullore simbas funksioneve që kryejnë* * *Klasifikimi i veshjeve popullore shqiptare* * *Shqyrtim historik-krahasues i disa elementeve të veshjeve popullore* * *Vendi i veshjeve shqiptare në kontekstin Ballkanik*

Veshja përbën një nga elementet më të rëndësishme të kulturës materiale shqiptare. Studimi dhe evolucioni i tyre gjatë shekujve, bën të mundur ndriçimin e disa aspekteve me interes të historisë shqiptare. Shihet që veshjet kanë ndryshuar vazhdimisht nga një periudhë historike në tjetrën, duke ndjekur zig-zaget e së kaluarës historike shqiptare.

Vepra shtjellon përmbajtjen dhe domethënien e pasur të formave të larmishme të veshjeve, zbulon elementet më me interes që mund t'i shërbejnë ripërtëritjes së vazhdueshme të kulturës shqiptare në procesin e zhvillimit të saj.

Duke ndjekur zhvillimin e tyre në kohë, vihet re se në veshjet e shek.XIV-XVI mungojnë të dhënat për veshjen e shtresës së njerëzve të thjeshtë, ndërsa për veshjen e shtresave të larta , të dhënat janë disi të kënaqshme. Gjatë mesjetës veshjet kanë krijuar tipare të përbashkëta ballkanike, në kulturën e tyre materiale, si rezultat i zhvillimit ekonomik e kulturor të Shqipërisë dhe i marrëdhënieve me popujt e tjerë të Ballkanit. Për veshjet e shekujve XVII-XIX burimet janë shumë më të pasura dhe më të shumëllojshme. Vihet re një shtrirje e varianteve të ngushta lokale në variante më të përgjithshme, duke sjellë kristalizimin e tipareve kombëtare në veshje. Tipologjia e tyre jep mundësinë që të përcaktohen mirë si dallimet ashtu dhe ngjashmëritë me veshjet e popujve të tjerë dhe të zbulohen lidhjet me veshjet e ilirëve.

Studimi mbështetet në materialet etnografike të mbledhura në terren, në njohjen e koleksioneve muzeale dhe në një informacion të gjerë nga burime të shumëllojshme dokumentare.

Numri i vendit në bibliotekë: 391.1 Gj 392

***Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800 / Dhimitër S. Shuteriqi. – Tiranë : [s.n.], 2005. - 412 f. ; 23 cm.**

PASQYRA E LËNDËS: * *Parathënie* * *Parathënie e botimit të parë* * *Parathënie e botimit të dytë* * *Shënim I autorit* * *Shekujt IX-XIII* * *Shekulli XIV* * *Shekulli XV* * *Shekulli XVI* * *Shekulli XVII* * *Shekulli XVIII* * *Bibliografi* * *Treguesit* * *Treguesi I* * *Treguesi II* * *Treguesi III* * *Treguesi IV*

Interes të veçantë për historinë e gjuhës së shkruar shqipe kanë shkrimet e para të kësaj gjuhe, që nga origjinat e njohura e gjer në mes të shek.XIX, - 1332-1850, të çdo lloji qofshin ato shkrime. Çdo gjë e shkruar në këtë periudhë i shërben studimit të gjuhës, njohjes së përpjekjeve të hershme kulturore të bëra nga shqiptarët si dhe të interesit që ka ngjallur në botë populli shqiptar, gjuha dhe kultura e tij në shekuj.

Është hulumtuar një det literature, botime vendase e të huaja, duke filluar që nga Mesjeta e hershme deri në periudhën moderne. Kërkimi mbyllet në vitin 1850, për faktin se në këtë periudhë fillon lëvizja e Rilindjes kombëtare shqiptare, kohë në të cilën shkrimi në gjuhën shqipe merr një hov dhe përpjestime shumë të ndjeshme.

Shkrimet i përkasin kohës së feudalizmit dhe sundimit të huaj feudal, për shkak se në Shqipërinë e asaj kohe ekzistonte kultura feudale, në dorë të klerit dhe sekteve të ndryshme fetare. Si reaksion ndaj kësaj kulture, nxiten përpjekjet për shkrimin e shqipes të nisur nga Buzuku, Budi etj. Ndërsa përpjekjet e klasës së re borgjeze, duken sidomos nga vitet 30-40 të shek.XIX, me De Radën, Veqilharxhin etj.

Botimi i mësipërm paraqet dialektikën e zhvillimit të shkrimit të gjuhës shqipe në të kaluarën.

Numri i vendit në bibliotekë: 016 Sh 978

***Prezantimi i teknologjisë së informacionit në biblioteka : Një paketë informative. - Tiranë, 1997. - 129 f. ; 23 cm.**

PASQYRA E LËNDËS: * *Si të përdorim këtë paketë informacioni* * *Hyrje në automatizimin e bibliotekës* * *Planifikimi dhe vënia në shfrytëzim e një sistemi të automatizuar për bibliotekat* * *Softi i bibliotekës* * *Softi i bibliotekës: Lista e kontrollit të funksioneve* * *Hyrje në teknologjinë e kompjuterave* * *Interneti* * *Disa sisteme të veçanta bibliotekare* * *ALEPH* * *CDS/ISIS* * *DYNIX* * *Datatrek Manager Series* * *INMAGIC* * *TINLIB* * *VTLS*

Materialet e paraqitura në këtë botim kanë për qëllim të japin një pasqyrë të plotë të mundësive dhe metodave rekomanduese për automatizimin e punëve rutinë në bibliotekë si dhe të përshkruajnë disa nga programet që gjenden aktualisht. Botimi përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë përmban një sërë seksionesh që përshkruajnë konceptet e përgjithshme të automatizimit të bibliotekave dhe rrugët e rekomanduara për vënien në shfrytëzim të sistemit. Pjesa e dytë përmban informacion për sistemet e veçantë të bibliotekave dhe mjetet për nxjerrjen e informacionit. Ajo përmban përshkrimet bazë të një numri produktesh që gjenden në treg dhe që janë përdorur së fundi në Evropën Qendrore dhe Lindore. Këto përshkrime shërbejnë vetëm si një udhëzues i përgjithshëm përmes pak shembujve, të dhënë pa bërë ndonjë konfirmim apo rekomandim për sisteme të caktuara.

Numri i vendit në bibliotekë: 025.5 P 802